

Themi Bello

Dhurata

FABULA

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-1
B 40



8 JH-1

1340

THEMI BELLO

DHURATA

fabula

66949

67
11 670

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Q1216/1A/117

ATARIHAT

1895

Tirazhi 1000 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1976

D R I T A

Brenda në një bahçe
jetonin njëherë,
bletë, brumbuj, miza,
grenza e të tjerë.

Gjithë ditën mbi lule
djersën derdhnin bletët,
brumbujt edhe grenzat
u merrnin të tretën.

U tha xixëllonja:
— Në vete nuk jeni!
Pse jepni të tretë
kur borxhe nuk keni?

Xixon sa dëgjuan,
grenzat më nuk pritën;
përsipër iu hodhën
trupin ia sfilitën.


Por e kishin kot,
xixot nuk u dhanë.
— Të luftojmë bashkë! —
bletëve u thanë.

Dhe kështu një mbrëmje
armikun sulmuan,
vendin rreth e qark
xixot e ndriçuan.

Brumbujt edhe grenzat
të tmerruar ikën,
bletët edhe xixot
ua kallën frikën...

BRESHKA DHE SHQIPONJA

Breshkës për pësime
ngado i ka dalë nami,
ndaj shpesh thonë:
«E gjeç si breshka te nallbani!»
Ç'e do, s'vuri mend
po pupla këndesi,



Shqiponjën sulmoi
në prill një mëngjesi.
— Dreee, po ç'pati breshka? —
Shqiponja u habit,
fort i rrahu flatrat,
mbi të u vërvit.
Sulmi e tmerroi
breshkën për ibret,
thirri «mama mia»
dhe ra tej në det...



DHELPRA ME VELADON


Dikur në malësi,
veshë n'rroben e priftit,
dhelpra thoshte lutje
në emër të Krishtit.



Kur ndonjë zoçkë
vinte pér rrëfim,
përgjysmë i linte
lutje dhe kungim;
nën veladon e merrte pranë:
— Pash sytë e bukur,
kalo matanë! —
Me ujq e çakenj
lidhi miqësi,
ndër shpezët e pyllit
shpesh bëri kërdi.
Një mbrëmje u kap
me presh në duar,
plot egërsira
në qelë kish strehuar.
Shpezët që e njihnin
mirë se cila ish,
si leckë e flakën
dhelprën me gjithë kishë...

ZAKON I VJETËR, MARIFET I RI

Në lëndinën plot bar
vajti ujku përsëri;
fshehtas, si dikur, i tha kaut më të ri:
— Jam ngushtë, vëlla, tek ju do të vij,
me ar e dollarë
ju blej meranë.



— Gabohesh! — tha kau, —
S'e blejmë belanë me pare, more mik,
prandaj nga sytë këmbët,
sa s'je në rrezik.
Përndryshe e ke hak
kurrizit një dajak...

RRUGË PA RRUGË

Dy makina,
me çimento ngarkuar,
në një udhëkryq
kishin qëndruar.

Në klub shoferët
pinin e këndonin,
ato të dyja
fshehtaz bisedonin.

— Për ku, moj motër?

— Për në Shkodër!


— Je në vete?
Ç'thua moj aman,
unë vij nga Shkodra
për në Elbasan.

— Kot që çuditesh!
S'është hera e parë;
sa herë kemi shpënë
tulla në Tiranë,

domate në Lushnje,
raki në Përmet,
gurë në gurore,
rërë në bregdet...

MUSHKA DHE DEVEJA

Deveja dhe mushka,
të ngarkuara mirë,
bashkë udhëtonin
nëpër shkretëtirë.



Tek ecnin në rërë
se si iu tek mushkës,
ia pati devesë:

— Moj xhane, moj krushkëz,
ç'i ke në kurriz
gungat gjithë shëmtim?
shiko sa i sheshtë
është kurrizi im:
i butë, i lëmuar,
nuk më vret samari...

— E di, — tha deveja, —
është kurriz gomari.

Ndërsa po zvaritej
në rërën e nxhëtë,
mushka e kapitur
iu qa devesë.

— Ngordha për ujë,
m'u tha fare gjuha!

— S'ke ç'bën, — tha deveja, —
këtu duhen gunga...

KULPRA DHE LISI

I thoshte kulpra
lisit njëherë,
— I lumi ti që, dimër dhe verë,
si kurorë të rri,
të gjelbëroj dhe zbukuroj
plot hijeshi.

Buzën në gas
vu lisi plak,
ia priti kulprës:

— Pa dale pak!
A u mendove shumë
për këto që thua?
Ti nuk jeton një ditë pa mua.
Unë nuk pranoj kurrë zbukurim
nga parazitë
që pinë gjakun tim.
Ndaj zhduku shpejt,
në djall të vesh!...

Kulprën parazite
e flaku në shesh.

GOMARI QË DESH TË BËHEJ PAPË

Për gomarin thonë
dikur ishte prift,
veshi veladon
me kryqin në bisht.

Me zell shërbente
në një kishë fshati,
shumë pretendime
nuk kishte veshgjati.

Një ditë na i lindi,
hajvanit të prapë,
dëshira për papë.
Të gjithë u habitën.

— Qenka çmendur qyqari,
nuk qenka në vete
ky bir gomari! —
U thotë hajvani:

— Po ç'dreq është kjo punë!
E pse çfarë ka papa
më tepër se unë?!


— Se papa, more vesho, —
ia priti një tjetër, —

s'është vetëm gomar
po dhe skile e vjetër...



PUNË PRIVATE

Kokoshi të shoqen
e mbante në kotec
duke shitur shtrenjtë
çdo kokërr vezë.



Në pijetore rrinte
deri pas mesnate, —
helbete, ushqhej
me punë private.

Nuk zgjati shumë,
i doli era punës,
sepse, për dreq,
kur i vinte veza pulës,
me të madhe niste
të kakariste.

Në kuvend u mblohdën
shpesët një të diel,
ia shkundën puplat
kaposhit dembel...

METRI FATKEQ

— Të isha më i shkurtër
imzot, patjetër,
do t'më deshte shumë! —
i thoshte një të diel banakut një metër. —
Ç'e do, nuk kam fat,
jam tepër i gjatë...
Tim zoti, që të than në laps e lctër,
do t'i pëlqente të isha
nëntëdhjetë centimetër.
Ndaj shpesh harron:
kur mat, shkurton...

DRURI I SHTREMBËR

Në pyllin me pisha,
për dreq, kish qëlluar
një dru fort i shtrembër
me degët ngatërruar.

Pishave u thoshte
mëngjes, darkë e drekë:
— Nuk pyes njeri,
në pyll zot jam vetë.

Po më bëtë naze,
unë do t'ju pérze,
sa të mos ju zënë
kurrë rrënjet dhe! —

Druri mburravec
shumë llomotiti,
fieri e dëgjoi,
me tallje ia priti:

— Çuditem me ty,
që lëvdohesh kot!
Ti me të vërtetë
tani je i fortë.

Po mos harro kurre
historinë time:
dikur qeshë sa trari,
sot jam sa një qime...

Dhe vërtetë druvari
në pyll nuk vonoi,
i vuri sëpatën
pyllin e pastroi...



MIZA DHE MERIMANGA

Një mizë e çalë
sillej vërdallë;
të reja mësonte
nëpër mëhallë.

Botën përziente
në muhabete,
në fund murmuriste:

— Kujdes, janë sekrete.
Këto që të thashë,
askush të mos i dijë!

Merimanga tinzake
mizën e dëgjoi,
një mbrëmje vonë
në fole e ftoi.

Me gjithë të mirat
atë e gostiti,
miza llafazane
shumë llomotiti

gjithë natën e natës
deri sa u lodh, —
rrjetën merimanga
pa mundim i hodh...

FUSTANI I BUKUR

Një mëngjes pranvere
flutura larushe
bridhte në lëndina
përmbi lule fushe.

Vetja i pëlqente
ndaj desh të dëfrente
duke tallur bletën.

I tha: — Keq më vjen!
E gjora ti,
punon gjithë ditën
dhe prapë zhveshur rri.

Ja, shikomë mua:
pa u lodhur fare
vishem mirë e bukur
si zonjë e madhe.

— Vërtetë vishesh bukur,
moj mendjelehtë, —
i tha buzagaz
punëtorja bletë. —

Veç nuk e mendon
se rrobat gjithë ngjyra,
nuk i ke me djersë, —
t'i fali natyra...



«P A P U N Ė S I»

Një ditë prej ditësh,
sorkadhja briartë
shkoi për studime
në një zoopark.

— Ke ardhur, — i thanë, —
për specializim,
pa pagesë i ke
fjetje dhe ushqim. —


Pas katër vjetësh
studimet mbaruan,
sorkadhen prapë
në pyll e emëruan.

Sorkadhja ia nisi
me pretendime,
duke nxjerrë sheshit
justifikime.

Me trishtim u lut:
— Më lini rehat
ta ushtroj zanatin
në zoopark.

Pérndryshe unë
nuk shkoj në punë,
jetës i bëj ballë,
kam prindët gjallë.

— Jo, jo, — thanë drerët, —
nuk ka më lezet;
boll të ushqyen
tani puno vetë...



M I Q Ė S I A

Një cjap budalla
me mjekër të gjatë,
nga tufa e dhive
u shkëput një natë,
ujkun e pabesë e bëri ortak.
Një herë kur ujku
mbeti i uritur
iu vërsul cjapit
si i babëzitur.
— Kaq qe miqësia,
tani do të ha;
kështu është kjo botë,
s'kam se ç'bëj! — i tha.
Thosh me vete cjapi:
«Të më bëhet mirë!
Ç'm'u desh miqësia
me një egërsirë?!...»

MIZA DHE BLETA

Tek pinte ujë pranë një korite
i foli bletës
një mizë parazite.

— E lumja ti, bredh në mijëra lule,
nuk të shan njeri,
të mbajnë me pekule.

Ndërsa unë e gjora
për pak e pësova,
njerzit më vunë drunë,
si leckë më përzunë;
në kuzhinë s'më qasin
kërkojnë të më vrasin.

— Unë vërtetë bredh në mijëra lule;
ama nxjerr mjaltë e hoja,
ti veç mikrobe lëshon nga goja...

N D I H M A

Në një tas të madh
mbushur plot me gjizë,
një mëngjes qershori
kish ngecur një mizë.

Kripën e tepruar
dot nuk e duroi,
ndaj një merimange
ndihmë i kërkoi.

Me vrap merimanga
ca fije i zgjati,
mizën e kapitur
e nxori nga tasi.

Shoqen falnderoi
dhe u mat të ikte,
në rrjetë qe ngatërruar,
këmbët s'i lëvizte.

I tha merimanga:
— Tani shpëto vetë,
një herë të ndihmova.
Pse hyre në rrjetë?...

KORBI DHE DHELPRA

Në degën e lisit
korbin kur e pa,
dhelpra iu qas pranë,
me lajka i tha:

— Ti je shpend i rrallë,
këngëtar i çmuar!
— E di, — i tha korbi, —
je e rrafinuar.

Veç sot mos u lodh,
djathi kushton lirë,
meqë jam i ngopur,
haje, të bëftë mirë! —

Dhe copën e djathit
e flaku në ferrë.
Dhelpra mbi shkurre
u sul menjëherë.

Copëzën e djathit,
në ferrë sa e gjet,
në barkun e zbrazur
e gëlltiti shpejt.

Veçse këtë herë
këngëtar i çmuar
dhelprës gënjeshtare
ia kishte punuar.

Djathë tē helmuar
ndrikullës i dha,
mes ferrash e gjembash
pa frymë e la...



NË UDHËTIM

Me shpejtësi, një të diel,
një «Zuk» dhe treni
ecnin paralel.
Treni tërhiqte
vagonët mbushur plot,
ndërsa «Zuku» veç tri arka bosh.
Tha lokomotiva:
— Si s'ke turp zotrote,
sa për të qenë brenda
është kjo puna jote.
Iu gjegj makina
— S'kam kundërshtim,
vërtetë harxhoj
goma dhe benzinë;
Po kam një shofer dhe axhensi
që më drejton.
Dëgjo një sekret: brenda në kabinë
është dhe shoku shef
që shkon «me shërbim»,
o shpirti im.
E kam si manare
në Tiranë ka ndeshje ndërkombëtare...

D H U R A T A

Në një shesh të pyllit rendën si vetëtimë,
nga të gjitha anët kafshët me nxitim.

U ngrit zonja dhelpër, në shesh u bë heshtje,
se rendi i ditës pritej me kureshtje:



— Të dashur miq, jemi mbledhur sot, —
ia nisi ndrikulla duke derdhur lot, —
për një problem, një lajmërim:
Çakalli nesër ka gëzim.

Marton të motrën, prandaj, me fushatë,
të mbledhim lekët për t'i bërë dhuratë! —
Dikush propozoi t'i çojnë një kostum...
Ia priti ketri: -- Ç'thua, mor malum?
Ti qënke i marrë: çakallin s'e kemi
as fis dhe as farë.

— Po, po, — tha drenusha, — mirë e tha ketri,
pse t'i shkundim xhepat kur marto het tjetri? —
E vetme mes tyre zonja dhelpër mbeti,
— Paguani, — u tha, — nuk u bë ki ameti!...
Kafshët u shpérndanë,
asnë grosh nuk dhanë,
po shku an uruan,
dasmorët gëzuan.
Dhelpra dinake
s'pati sy e faqe.

DEMI DHE TOREADORI

Një mbrëmje me vapë
në muajin qershori,
përlleshej demi me një toreador.
Nga lodhja dhe vapa
djersë u kullonin,
njerzit që nga shkallët me britma i
ngacmonin


Për një çast, demi
e zuri papritur
në cepin e murit
viktimën e drobitur.

Iu lut toreadori:

— Lermë të të rrëzoj,
sonte patjetër më duhet të fitoj,
përndryshe imzot
nga puna do t'më flakë,
kam grua e fëmijë, kam nënën plakë!

— Ke të drejtë, — tha demi, —
se mbetesh pa punë,
veç, more vëllaçko, më keq e kam unë:
po humba dhe sot
e pësoj si cjapi,

imzot nuk perton, më çon te kasapi.
Prandaj s'ke se ç'bën,
duro mos u qaj,
ky eshtë ligji i xhunglës, more xhan vëllai...



LOTË KROKODILI

(*Në Perëndim*)

Gjykohej krokodili
se, gjoja gabimisht,
në lumë kish gëlltitur
majmunin me gjithë bisht.

Betohej i gjori:
— Jam penduar shumë! —
lotët e nxehtë
i derdhë si lumë.

Dikujt nga salla
i erdhi keq,
gjyqtarëve u foli:
— E lini këtë dreq.

Të këput shpirtin
kur derdh ata lotë,
nuk ka faj i gjori
ç'e mundoni kot.

Ujku u tregua
mjeshter si pérherë,
po e zgjatur, mori
një vendim të prerë.



— S'ka faj krokodili,
faj ka majmuni;
ç'i duhej atij
të pinte ujë lumi?...

— Jo, jo! — tha një dre, —
Mos e lini!
Ato që shikoni
janë lotë krokodili! —

P A S Q Y R A E L È N D È S

Drita	3
Breshka dhe shqiponja	5
Dhelpra me veladon	7
Zakon i vjetër, marifet i ri	9
Rrugë pa rruge	11
Mushka dhe deveja	13
Kulpra dhe lisi	15
Gomari që desh të bëhej papë	16
Punë private	18
Metri fatkeq	20
Druri i shtrembër	21
Miza dhe merimanga	23
Fustani i bukur	24
«Papunësi»	26
Miqësi	28
Miza dhe bleta	29
Ndihma	30
Korbi dhe dhelpra	31
Në udhëtim	33
Dhurata	34
«Transferim»	36
Demi dhe toreadori	38
Lotë krokodili.	40